



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PËRFAQËSUESVE TË MEDIAS "AL JAZEERA BALKANS,**  
**AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE,REVISTA ZEMËR" NË ZGJEDHJET PËR**  
**ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS**  
**30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimi i gazetarëve të paraqitur nga " Al Jazeera Balkans, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Revista Zemër" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

**V Ë R E N**

Agjencia e lajmeve " Al Jazeera Balkans, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Revista Zemër" me aktivitet në fushën e medias kanë paraqitur kërkesën e tyre përkatësisht me nr.Prot.12113 të datës 21.06.2019, nr.prot11969 të datës 20.06.2019; nr.prot.12016 të datës 21.06.2019 bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditim e 3 (tre) gazetarëve të Al Jazeera Balkans; të 6 (gjashtë) gazetarëve të ATSH dhe 1 (një) gazetar të Revistës Zemër .



**Nr. 852 i Vendimit**

**Data 22.06.2019**

**Ora 12.<sup>00</sup> e Vendimit**

Për miratimin e gazetarëve të paraqitur nga Al Jazeera Balkans, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Revista Zemër për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se kërkesa e paraqitur nga Al Jazeera Balkans respekton afatin kohor të parashikuar nga Kodi Zgjedhor ndërsa kërkesat e paraqitura nga Agjencia Telegrafike Shqiptare dhe Revista Zemër” janë paraqitur jashtë afatit .

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma “a”, neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e Agjencisë së lajmeve “ Al Jazeera Balkans, për akreditimin e 3 (tre) gazetarëve; si dhe të miratojë kërkesën e Agjencia Telegrafike Shqiptare(ATSH) për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve dhe Revista Zemër për akreditimin e 1 (një) gazetari, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listave të përcaktuar në lidhjen Nr.4, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 852 i Vendimit**

**Data 22.06.2019**

**Ora 12.<sup>00</sup> e Vendimit**

Për miratimin e gazetarëve të paraqitur nga Al Jazeera Balkans, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Revista Zemër për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019